

UDHËZIM
Nr. 29, datë 18.12.2019

**PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORE TË
GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “g”, të pikës 2, të nenit 7, dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘profesor i asociuar’ dhe ‘profesor’”, vendimit nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Regjistrat shtetërorë për regjistrimin e gradës shkencore “doktor” dhe titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” janë një bazë unike të dhënash e të gjitha gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fuqi.

2. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë janë:

- a) Regjistri shtetëror për gradën shkencore “doktor”.
- b) Regjistri shtetëror për titullin akademik “profesor i asociuar”.
- c) Regjistri shtetëror për titullin akademik “profesor”.

3. Regjistrat shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Republikën e Shqipërisë, krijohen dhe administrohen në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

4. AKKSHI-ja harton një rregullore të veçantë mbi administrimin e regjistrave.

5. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë mbahen në formë të shkruar (me dorë) dhe format elektronik, sipas formatit të përcaktuar në këtë udhëzim. Regjistrat në formë të shkruar (me dorë) plotësohen nga punonjësi i autorizuar i AKKSHI-së. Në rast mospërputhje të dhënash, merren për bazë të dhënat e regjistrave në formë të shkruar (me dorë). Regjistrat e mbajtur në formë të shkruar (me dorë), depozitohen në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat.

6. Përdorimi dhe përpunimi i të gjithë informacionit dhe të dhënave të gjeneruara si rezultat i procedurave të regjistrimit, kryhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

7. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja elektronike e të dhënave realizohet nëpërmjet një sistemi të informatizuar që administrohet me rregullore të veçantë.

KREU II
TË DHËNAT E REGJISTRAVE

1. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të gradës shkencore “doktor”:

- a) Numri rendor.
- b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet grada shkencore “doktor”.

- c) Gjinia.
 - d) Datëlindja.
 - e) Shtetësia.
 - f) Emërtimi i institucionit/ve të arsimit të lartë ku personi ka kryer studimet e doktoratës.
 - g) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë, i njësisë kryesore dhe/ose njësisë bazë që jep gradën shkencore “doktor”.
 - h) Forma e studimit.
 - i) Numri i matrikullimit.
 - j) Data e regjistrimit në programin e studimit të doktoratës.
 - k) Numri dhe data e Vendimit të jurisë për dhënien e gradës shkencore “doktor”.
 - l) Data e regjistrimit në regjistër të gradës shkencore.
 - m) Tema e disertacionit.
 - n) Fusha e studimit dhe vlerësimi.
2. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të titullit akademik “profesor i asociuar”:
- a) Numri rendor.
 - b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet titulli akademik.
 - c) Gjinia.
 - d) Datëlindja.
 - e) Shtetësia.
 - f) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë që lëshon titullin akademik.
 - g) Numri dhe data e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
 - h) Data e regjistrimit në regjistër e titullit akademik.
 - i) Fusha e studimit.
 - j) Data e fitimit të gradës shkencore “doktor”.
3. Të dhënat që plotësohen në regjistrin shtetëror të titullit akademik “profesor”:
- a) Numri rendor.
 - b) Emër, atësi dhe mbiemër të personit të cilit i jepet titulli akademik.
 - c) Gjinia.
 - d) Datëlindja.
 - e) Shtetësia.
 - f) Emërtimi i institucionit të arsimit të lartë që lëshon titullin akademik.
 - g) Numri dhe data e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
 - h) Data e regjistrimit në regjistër e titullit akademik.
 - i) Fusha e studimit.
 - j) Datën e fitimit të titullit “profesor i asociuar”.

KREU III KRITERET PËR REGJISTRIM

1. Institucionet e arsimit të lartë përcjellin pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin kërkesën dhe informacion mbi çdo gradë shkencore apo titull akademik të lëshuar prej tyre. Shkresa/kërkesa zyrtare përmban:

- a) Për regjistrimin e gradës shkencore “doktor”:
 - i) Emër, atësi, mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet grada shkencore.
 - ii) Forma e studimit.
 - iii) Numrin e matrikullimit.
 - iv) Temën e disertacionit.
 - v) Datën e regjistrimit në studimet e Doktoratës.
 - vi) Kopje elektronike (CD) të disertacionit në formatin *word* dhe *pdf*.
 - vii) *Linkun*/ adresën e faqes *web* në të cilin është publikuar disertacioni përkatës.

Viii) Numrin dhe datën e vendimit të jurisë. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

ix) Fushën e studimit.

x) Konfirmimi që është kryer kontrolli antiplagjiaturë i disertacionit të mbrojtur për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe njoftimi i programit/*soft*-it përkatës të përdorur.

b) Për regjistrimin e titullit akademik “profesor i asociuar”:

i) Emër, atësi dhe mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet titulli akademik “profesor i asociuar”.

ii) Numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

iii) Numrin dhe datën e vendimit të fitimit të gradës shkencore “doktor”.

c) Për regjistrimin e titullit akademik “profesor”:

i) Emër, atësi dhe mbiemër, shtetësia, datëlindja dhe gjinia e personit të cilit i jepet titulli akademik “profesor”.

ii) Numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik. Të bashkëlidhet kopje origjinale e vendimit përkatës, si dhe procesverbali (nëse është mbajtur një i tillë).

iii) Numrin dhe datën e vendimit të fitimit të titullit akademik “profesor i asociuar”.

KREU IV REGJISTRIMI

1. Regjistrat shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë plotësohen sipas formatit të shtojcave përkatëse bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, si dhe fillojnë me numrat rendorë:

a) A01 - Regjistri shtetëror i gradës shkencore “doktor” (shtojca nr. 1).

b) B01 - Regjistri shtetëror i titullit akademik “profesor i asociuar” (shtojca nr. 2).

c) C01 - Regjistri shtetëror i titullit akademik “profesor” (shtojca nr. 3).

2. Specialisti/struktura përgjegjëse për plotësimin e regjistratit shtetëror përkatës, në rastet kur kërkesa e IAL-së nuk është hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III, të këtij udhëzimi, i kërkon IAL-së plotësimet e nevojshme.

3. Kur kërkesa e IAL-së për regjistrimin e gradës shkencore dhe/ose titullit akademik, është hartuar sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III të këtij udhëzimi, brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës, kryhet regjistrimi në regjistrin përkatës shtetëror dhe njoftohet zyrtarisht IAL-ja për numrin e regjistratit.

KREU V PROCEDURA E REGJISTRIMIT

1. Kërkesa zyrtare për regjistrimin e gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës përcillet pranë AKKSHI-së, pas plotësimit nga IAL-ja të kriterëve dhe ndjekjes së procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

2. Regjistrimi i gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës nuk certifikon përmbushjen e kriterëve, procedurave dhe modaliteteve për fitimin e tyre, të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

3. Në rast se në vijim të kontrollit nga ministria përgjegjëse për arsimin konstatohen parregullsi në dhënien e gradave shkencore apo titujve akademikë, AKKSHI-ja rezervon të drejtën për të çregjistruar gradën shkencore/titullin akademik nga regjistri shtetëror përkatës.

4. Dokumentet shoqëruese të kërkesës së IAL-së duhet të jenë në origjinale ose kopje të njehsuara me origjinalin. Dokumentet duhet të jenë të saktë dhe të plotë.

5. Dokumentet duhet të jenë në gjuhën shqipe, ose të përkthyer dhe të vërtetuara në gjuhën shqipe dhe të legalizuara sipas legjislacionit në fuqi.

KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

1. Regjistri shtetëror i gradave shkencore “doktor”, i krijuar dhe plotësuar përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, mbyllet dhe arkivohet sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

2. AKKSHI-ja përcjell informacion në MASR lidhur me regjistrimet e kryera, çdo gjashtë muaj.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

